



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština – Assembly*

---

Legjislatura VI  
*Sesioni pranveror*

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,  
për Persona të Pagjetur dhe Peticione

P-nr.42/2019

Prishtinë, më 28 janar 2019

**PROCESVERBAL**

Në mbledhje morën pjesë: Duda Balje, Lirije Kajtazi, Mirjeta Kalludra, Mexhide Mjaku-Topalli, Luljeta Veselaj-Gutaj, Saranda Bogujevci, Shemsi Syla, Teuta Haxhiu dhe Veton Berisha.

Munguan: Sasha Milosavljeviq dhe Fisnik Ismaili.

Stafi mbështetës i Komisionit: Selman Ymeri, koordinator dhe Sulltane Gashi, zyrtare e fushës.

Pjesëmarrës të tjerë: Emine Jakupi-praktikante GP-LDK, Leart Jusufi-KDI, Nora Kelmendi-Ekonomia Online, Vlora Selimi-Arbresh.info, Dardane Neziri-Koha Ditore, Miranda Shala-Ambasada e Britanisë së Madhe, Rron Agolli-Arbresh-info, dhe Zana Ulaj, praktikante në Kuvendin e Kosovës.

Mbledhjen e kryesoi, Duda Balje, kryetare e Komisionit.

**Rendi i ditës:**

- 1. Shqyrtimi i Draft-planit të punës për vitin 2019:**
- 2. Të ndryshme.**

\*\*\*

**1. Shqyrtimi i Draft-planit të punës për vitin 2019**

Kryetarja, tha se për Planin e Punës kemi diskutuar edhe në mbledhjen e kaluar, por do të fillojmë me shqyrtim dhe propozime eventuale për secilin muaj, veç e veç.

Mexhide Mjaku-Topalli, tha se në muajin shkurt ka propozuar që të mbahet një tryezë, ku do të diskutohet për zbatimin e strategjisë për personat me aftësi të kufizuara dhe nga kjo tryezë të dalim me rekomandime. Një nga rekomandimet që do të jetë, do të procedohet shpejt si koncept dokument i Qeverisë, për ligjin gjithë përfshirës për personat me aftësi të kufizuara. Ajo, propozoi që të mbahet një konferencë me të gjithë aktorët e brendshëm përgjegjës, lidhur me Ligjin për barazi gjinore. Pas diskutimeve, anëtarët e Komisionit u pajtuan që kjo konferencë të organizohet nga ana e Grupit të Grave Deputete.

Lirije Kajtazi, tha se shqyrtimi i Projektligji për Peticionet, duhet të mbetet në plan të punës sepse është në procedurë dhe pavarësisht se si vendos seanca, sepse edhe ashtu kemi një draft dhe nëse nuk kalon ky që është në procedurë, duhet të vazhdohet me draftin që e ka përgatitur Komisioni FunkSIONAL.

Saranda Bogujevci, propozoi që në muajin mars në bashkëpunim me Galerinë e Arteve të bëhet një ekspozitë në Kuvend, me veprat e grave artiste.

Teuta Haxhiu, tha se për shënimin e përvjetorit të masakrës së Dubravës, në muajin maj është mirë t'i paraprijmë me organizime në muajin prill, dhe një ndër kërkesat kryesore të familjarëve gjatë takimit që kishim vitin e kaluar, ishte që lapidari të ndërtohet në vendin ku ka ndodhur masakra. Ju kemi premtuar që këtë çështje do ta iniciojmë në Kuvend, dhe propozoj mbajtjen e një tryeze, në lidhje me këtë çështje, në muajin prill.

Mexhide Mjaku-Topalli, tha se ka qenë propozim i saj që në muajin prill të mblidhet Komisioni i ynë dhe Komisioni për Media, që të krijojmë një Këshill organizativ për të shënuar 20 vjetorin e masakrës së burgut të Dubravës. Kishim edhe propozime të tjera nga mbledhja e kaluar, dhe kërkojmë që monumenti të ndërtohet aty tek vendi ku janë pishat, ku është kryer ekzekutimi i të burgosurve politikë. Kjo është kërkesë edhe e familjarëve.

Shemsi Syla, theksoi se ne duhet të bëjmë përpjekje për rikthimin e gjurmëve, të kërkojmë që monumenti të vendoset aty ku ka ndodhur ngjarja dhe të kërkojmë që ai vend të bëhet muze. Duhet ta sensibilizojmë opinionin, qoftë edhe me mbajtjen e një seance, apo forme tjetër, siç është më së miri. Së paku atë ditë, të vendoset gurthemeli i atij monumenti, dhe nga të gjitha instancat të kërkohet që të mblidhen dhe të ruhet i gjithë materiali, gjurmët dhe të dhënat mbi këtë ngjarje.

Saranda Bogujevci, tha se është me rëndësi që kur të flitet për burgun e Dubravës, ta kemi dokumentim institucional. Sa u përket monumenteve, është shumë me rëndësi atë ditë me u vu gurthemeli dhe të tregohet historia se çka ka ndodhur atje.

Lirije Kajtazi, tha se është një ngjarje që kërkon angazhimin e shumë institucioneve dhe është mirë të formohet një Këshill organizativ për shënimin e 20 vjetorit të masakrës në burgun e Dubravës. Ajo propozoi që znj. Mexhide Mjaku-Topalli, të jetë kryesuese e këtij Këshilli. Pastaj, Këshilli organizativ merret me konkretizimin e punëve dhe me të gjitha aktivitetet tjera.

Komisioni mori Vendim që znj. Mexhide Mjaku-Topalli, të udhëheqë Këshillin organizativ për shënimin e 20 vjetorit të masakrës në burgun e Dubravës.

Këshilli organizativ, për të gjitha aktivitetet të njoftojë anëtarët e Komisionit.

Luljeta Veselaj-Gutaj, tha se në plan të punës të vendosen edhe vizita të tjera për shënimin e ditës së personave të zhdukur, edhe vizita në Krushë të Vogël dhe në Krushë të Madhe, si dhe të bëhen vizita edhe në komuna të tjera.

Mirjeta Kalludra, tha se është mirë të dilet me një reagim lidhur me vazhdimin e grevës nga ana e SBASHK-ut, kur jemi në javën e tretë të kësaj greve dhe mendoj se mosmbajtja e mësimit për nxënësit, po i dëmton në mënyrë direkte ata.

Kryetarja, njoftoi për përgjigjen që kanë marrë nga Komisioni qeveritar për persona të zhdukur lidhur me Projektligjin për persona të zhdukur, dhe u vendos që Komisionin qeveritar të ftohet në fillim të prillit, për të diskutuar se çka është bërë lidhur me Projektligjin.

Veton Berisha, tha se komunitetet romë, ashkali dhe egjiptianë, ballafaqohen me shumë shkelje të të drejtave të njeriut dhe propozoi që në Planin e Punës të futet një aktivitet që u dedikohet këtyre komuniteteve e ndoshta edhe me përfunduar me një konferencë, ku do të diskutohej për çështjet me të cilat ata ballafaqohen. Ai tha, se kur flitet për të vrarët dhe të zhdukurit, nuk flitet për komunitetin egjiptian, ku konsiderohet se janë mbi 200 të vrarë.

Në vazhdim, kryetarja njoftoi Komisionin se OSBE-ja, do të mbështesë Punëtorinë për shqyrtimin e Projektligjit për Mbrojtjen e Fëmijës, nga data 22 shkurt 2019, që do të mbahet në Shqipëri ose në Mal të Zi, kurse më pas, në mungesë të kuorumit, e ndërpreu mbledhjen dhe tha se kjo pikë e rendit të ditës, do të vazhdohet në një ditë tjetër, për çka do të njoftoheni me kohë

\*\*\*

### **30 janar 2019,**

**Vazhdimi i mbledhjes së filluar më 28 janar, u bë me datën 30 janar 2019, në orën 9:00, në sallën N-302**

Në vazhdimin e mbledhjes morën pjesë: Duda Balje, Lirije Kajtazi, Mexhide Mjaku-Topalli, Luljeta Veselaj-Gutaj, Saranda Bogujevci, Teuta Haxhiu dhe Veton Berisha.

Munguan: Sasha Milosavleviq, Mirjeta Kalludra, Shemsi Syla, dhe Fisnik Ismaili.

Kryetarja tha se po vazhdojmë me pikën e rendit të ditës - Shqyrtimin e planit të Punës.

Më pas, nuk pati asnjë propozim për plotësimin e planit të punës të Komisionit për sesionin pranveror.

Kryetarja konstatoi se propozimet e dhëna për planin e punës për sesionin pranveror nga mbledhjet e kaluara, ato tani më janë përfshirë. Kryetarja konstatoi se plani i punës për Sesionin vjeshtor 2019, do të rishikohet, pas fillimit të punimeve të këtij sesioni

Kryetarja, më pas hodhi në votim miratimin e draft-planit të punës për vitin 2019.

Kryetarja Konstatoi se plani i punës për vitin 2019 u miratua njëzëri, me propozimet e plotësuara dhe të paraqitura nga anëtarët e Komisionit.

## 2. Të ndryshme

Kryetarja, tha se kemi diskutuar për çështjen e personave të pagjetur, për këtë çështje është mirë të caktohet anëtarja e Komisionit, Saranda Bogujevci.

Teuta Haxhiu, tha se çështja e personave të zhdukur është një çështje e ndjeshme dhe se dëshiron të jetë e përfshirë për këtë çështje, meqenëse vjen nga një vend i cili ballafaqohet me çështjen e personave të zhdukur.

Lirije Kajtazi tha se ne do të angazhohemi secili aq sa mundemi, por besoj se Saranda do të ishte një person adekuat, e cila do ti kishte përcjellë këto aktivitete, ngase ajo ka një përparësi edhe në komunikim me autoritetet ndërkombëtare.

Saranda Bogujevci, tha se tash një vit është duke u diskutuar për të formuar grupin dhe kush do ta udhëheq grupin, tha se për të nuk është fare me rëndësi. Me rëndësi është të punohet dhe të ecin proceset para. Ajo tha se edhe në qoftë se ka deputetë tjerë të interesuar të merren me këtë çështje, mund të bashkëngjiten dhe të kontribuojnë, si psh. Driton Çausi dhe Andin Hoti, dëshirojnë të jenë pjesë e këtij grupi dhe të japin kontributin për këtë çështje.

Pas diskutimeve, kryetarja konstatoi se Komisioni mori Vendim që kryesuese e grupit punues për të pagjeturit të jetë, Teuta Haxhiu, ndërsa anëtarë të grupit punues janë: Lirije Kajtazi, Luljeta Veselaj-Gutaj, Saranda Bogujevci dhe Veton Berisha.

Kryetarja, njoftoi anëtarët e Komisionit për kërkesën e autores nga Shqipëria znj. Lola Shehu, lidhur me mbështetjen financiare nga Kuvendit i Kosovës, për botimin e një libri për gratë e dhunuara gjatë luftës në Kosovë.

Kryetarja konstatoi se Komisioni pajtohet që kërkesa e lartpërmendur të procedohet për miratim në Kryesi të Kuvendit.

Teuta Haxhiu, propozoi që në takimin e paraparë të Grupit të Grave deputete me Komisionin qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të grave të dhunuara gjatë luftës, të marrin pjesë edhe anëtarët e Komisionit FunkSIONAL, të hënën më 4 shkurt 2019.

Kryetarja konstatoi se Komisioni do të mbledhet më 4 shkurt, së bashku me Grupin e Grave deputete, ku është ftuar Komisioni qeveritar.

Mexhide Mjaku-Topalli, tha se meqenëse nisma për ndryshim plotësimin e ligjit për mbrojtje nga dhuna në familje ka hy në agjendë, propozon që të formohet grupi punues.

Pas diskutimeve për këtë çështje, kryetarja konstatoi se Komision mori vendim për formimin e grupit punues për nismën për ndryshim plotësimin e Ligjit për mbrojtje nga dhuna në familje në këtë përbërje.

Mexhide Mjaku-Topalli, kryesuese, Duda Balje, Mirjeta Kalludra, Shemsi Syla e Teuta Haxhiu, anëtarë.

Mbledhja përfundoi në orën 10:00.

*E përgatiti:*

*Stafi mbështetës i Komisionit.*

Kryetarja e Komisionit,

---

Duda Balje